



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 PRILL 2020**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. APRILA 2020. GODINE**

**PRILL - APRIL
2020**

Rendi i ditës

1. Propozimi dhe miratimi i masave konkrete ekonomike e financiare që duhet t'i ndërmarrë Republika e Kosovës për t'i tejkaluar sfidat e rimëkëmbjes ekonomike në adresimin e pasojave të pandemisë së Corona Virusit "COVID-19", me qëllim të përballimit sa më të suksesshëm të pasojave të shkaktuara (aktuale dhe të ardhshme), në drejtim të parandalimit të krizës eventuale ekonomike, zvogëlimit të humbjeve ekonomike dhe ofrimin e mbështetjes së domosdoshme veçanërisht për sektorin privat në Kosovë.

Dnevni red

1. Predlog i usvajanje konkretnih finansijskih i ekonomskih mera koje treba preduzeti Republika Kosovo za prevazilaženje izazova ekonomske obnove u adresiranju posledica pandemije Corona Virusa “COVID-19”, u cilju što uspešnijeg suočavanja sa nanetim posledicama (aktuelnih i budućih), u pravcu sprečavanja eventualne ekonomske krize, smanjenju ekonomskih gubitaka i pružanju neophodne pomoći, posebno privatnom sektoru na Kosovu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Për momentin 30 deputetë janë në sallë, nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të filluar seanca.

Besoj që për afërsisht për diku 30 minuta mund të vijmë edhe deputetët tjerë, meqenëse janë duke kaluar nëpër kontrolle mjekësore të organizuara nga Instituti i Shëndetit Publik. Kështu që, presim ndërkohë edhe 30 minuta për të filluar zyrtarisht seancën.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës)

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Ju lutem uluni në ulëset tuaja. Mbajeni distancën sipas rekomandimeve të Institutit, ju lutem!

Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e mbështetur nga 48 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, që do të thotë ka kuorum të mjaftueshëm për të filluar kjo seancë.

Një sqarim procedural para se të procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës. E pashë që në media ka reagime të ndryshme lidhur me një vendim për qarkullim të lirë të deputetëve. Dua t'ju njoftoj që si kryetare e Kuvendit nuk kam bërë asnjë kërkesë nga institucionet përgjegjëse për qarkullim të deputetëve.

Natyrisht që të gjithë e dimë që mandati i deputetit është i lirë dhe je detyrues, por po ashtu e ndiej obligim t'ju njoftoj që ka pasur kërkesa nga disa grupe parlamentare dhe deputetë individual përfshirë pastaj edhe Administratën e Kuvendit, drejtuar Administratës që Administrata ta kontaktojë policinë dhe institucionet tjera përgjegjëse për të siguruar qarkullim të lirë për shkak të deputetëve dhe Administratës, për shkak të garantimit të disa komunave prej nga vijnë deputetët dhe po ashtu karantinimit të Prishtinës.

Pra, kërkesa, pastaj nga Administrata i është drejtuar institucioneve përgjegjëse, në radhë të parë policisë dhe pastaj Ministrisë së Brendshme. Po ju njoftoj sërish, nuk është ndonjë kërkesë që është dërguar nga unë si kryetare e Kuvendit, por megjithatë, sot në mëngjes jam njoftuar nga

Administrata që ka pasur kërkesë që të ketë lehtësim në qarkullim nga ana e disa grupeve parlamentare.

Ky është njoftimi që e kam marrë. Pra, është kërkuar lehtësim në qarkullim për shkak se disa deputetë vijnë nga komuna që tashmë janë në karantinë dhe po ashtu Prishtina është karantinuar para disa ditëve. Ky ishte si sqarim në fillim të seancës.

1. Propozimi dhe miratimi i masave konkrete ekonomike e financiare që duhet t'i ndërmarrë Republika e Kosovës për t'i tejkaluar sfidat e rimëkëmbjes ekonomike në adresimin e pasojave të pandemisë së Corona Virusit "COVID-19", me qëllim të përballimit sa më të suksesshëm të pasojave të shkaktuara (aktuale dhe të ardhshme), në drejtim të parandalimit të krizës eventuale ekonomike, zvogëlimit të humbjeve ekonomike dhe ofrimin e mbështetjes së domosdoshme veçanërisht për sektorin privat në Kosovë

Tani mund të procedojmë me propozimin dhe miratimin e masave konkrete ekonomike-financiare që duhet t'i ndërmarrë Republika e Kosovës, për t'i tejkaluar sfidat e rimëkëmbjes ekonomike në adresimin e pasojave të pandemisë së coronavirusit COVID-19, me qëllim të përballimit sa më të suksesshëm të pasojave të shkaktuara, aktuale dhe të ardhshme në drejtim të parandalimit të krizës eventuale ekonomike, zvogëlim të humbjeve ekonomike dhe ofrimin e mbështetjes së domosdoshme, veçanërisht për sektorin privat në Kosovë, si kërkesë e parashtruar me shkrim nga 48 deputetë të Kuvendit të Republikës, në përputhje me Kushtetutën e vendit.

Fjalën në emër të propozuesit e ka kërkuar zoti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni që të paraqesë një mocion procedural që ka të bëjë me futjen e dy projektligjeve më procedurë të shqyrtimit në Kuvend.

Duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, propozoj që në kuadër të punimeve të kësaj seance të jashtëzakonshme, të shqyrtojmë dy projektligje të cilat pasi që i kemi dërguar në Kuvend dhe i kanë kaluar procedurat paraprake të Kuvendit, nga sot t'i nënshtrohen proceduarave të shqyrtimit parlamentar.

Bëhet fjalë për dy projektligje të propozuara nga Grupi Parlaemntar i PDK-së, të cilat janë:

1. Projektligji për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë COVID-19, dhe

2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 03/L-221 me ligjin nr. 04/L-116 dhe ligjin nr. 04/L-194 dhe ligjin nr. 05/L-1063 dhe Ligjin nr. 05/L-007

Këto dy nisma ligjore i kemi propozuar në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të ligjit nr. 04/L-025 për Nisma Legjislative dhe nenit 53 të Rregullores së Kuvendit.

Konsiderojmë se shqyrtimi i këtyre dy projektligjeve është i natyrës urgjente, prandaj edhe përfshirja e tyre në rend të ditës së mbledhjes së sotme për shqyrtim parlamentar është po ashtu e domosdoshme.

Këto dy nisma ligjore i kemi paraqitur të premtën në Zyrën për Propozime dhe Parashtresa të Kuvendit, natyrisht pasi janë marrë deklaratat përkatëse, pra deklarata për ndikimin buxhetor dhe deklarata e pajtueshmërisë me të drejtat e BE-së, si dhe është bërë lekturomi dhe përkthimi i tyre në pajtim me Rregulloren.

Tani meqë, pikërisht kjo seancë është thirrur me qëllim të propozimit dhe marrjes së masave të karakterit financiar dhe fiskal, dhe meqë këto projektligje i adresojnë pikërisht këto masa, propozoj që Kuvendi, nëpërmjet të mocionit procedural të përfshijë në rend të ditës së kësaj seance, të shqyrtohen në parim këto dy projektligje dhe natyrisht nëse ka pajtueshmëri, për shkak të gjendjes aktuale të pandemisë COVID-19, shqyrtimi i këtyre projektligjeve të bëhet me procedurë të përshpejtuar duke u bazuar në nenit 84 të Rregullores.

Në këtë mënyrë, duke votuar për përfshirjen në rend të ditës së mbledhjes së sotme të këtyre projektligjeve do të konsumohej edhe draft-rezoluta e propozuar, por edhe të ndërmarrin një hap konkretë juridik e politik që është vendimtar për t'i dalë përballë situatës si pasojë e pandemisë.

Prandaj, në pajtim me nenin 49, shqyrtimi i çështjeve urgjente në Kuvend, si dhe nenit 50 të Rregullores, propozoj mocion procedural për përfshirjen e projektligjeve të mësipërme për shqyrtim në seancën e sotme.

Gjithashtu, dua të theksoj se aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në çështjen e shqyrtimit të kushtetutshmërisë të masave të propozuara me Kushtetutë, Gjykata ka konstatuar se Kuvendi duhet të marrë vendime dhe veprime për menaxhimin e duhur të pandemisë.

Prandaj, në frymëzimin e zbatimit të këtij aktgjykimi, janë edhe masat e propozuara nga Partia Demokratike e Kosovës, nëpërmjet këtyre dy projektligjeve. Faleminderit!

KRYETARJA: Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën, nënkryetari i Kuvendit.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një vërejtje që lidhet me çështjen që paraqiti kolegu Hamza. Kjo është një seancë e jashtëzakonshme me një pikë të rendit të ditës që lidhet me një çështje specifike.

Sipas Rregullores dhe praktikës së punës së Kuvendit, në seancat e kësaj natyre, pra, në seancat e jashtëzakonshme nuk mund të paraqiten mocione të tilla. Kuvendi mund të trajtojë vetëm çështjen që është përcaktuar nga iniciuesi i seancës.

KRYETARJA: Pikërisht, unë nuk kam mundësi që për shkak të rregullave që i përmendi edhe nënkryetari i Kuvendit, që të vendos një mocion të tillë në votim për këtë seancë të jashtëzakonshme, meqenëse është thirrur vetëm për një pikë të rendit të ditës, por natyrisht që procedurat për ato që i përmendet, ekzistojnë edhe mund të kërkojnë në ndërkohë.

Një sqarim shtesë, meqenëse e përmendët aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili thotë qartë që Kuvendi mund të nxjerrë ligje që kanë të bëjnë me masat kufizuese.

Siç e dini në mbledhjen e fundit të Kryesisë dhe pas konsultimit me institucionet të cilat me parandalimin e pandemisë, unë i kam bërë një sërë propozimesh, disa grupe i kanë përkrahur disa jo, mirëpo një sërë propozimesh, në mënyrë që Kuvendi ta miratojë këtë ligj sa më urgjent që të jetë e mundshme.

Kam propozuar që të formohet grup punues, është refuzuar. Kam propozuar që Komisioni për Shëndetësi ta hartojë urgjent, është refuzuar, madje është thënë që Kuvendi nuk mund të hartojë asnjë ligj derisa të ndryshohet Qeveria. Pra, ky është një sqarim meqenëse e përmendet që ekziston një nismë e tillë dhe meqenëse deri tash nuk ka marrë përkrahje të qartë nga grupet parlamentare, unë besoj që brenda 24 orëve do të detyrohem që ta procedojmë si nismë legislative dhe shpresoj që deputetët, duke e pasur parasysh urgjencën për një ligj të tillë të veçantë për ta trajtuar çështjen e masave kufizuese, edhe do t'ia japim një ligji të tillë përkrahjen e nevojshme.

Pra, nuk është që nuk ka pasur nismë të tillë siç e dini, e kam trajtuar në Kryesi, por nuk ka pasur përkrahje deri tani. Dhe, sot e kemi marrë nga Komisioni për Legjislacion vendimin, i cili përkundër faktit që konstaton se Gjykata Kushtetuese ka kërkuar që të miratohet një ligj i tillë, po ashtu konstaton që, ndoshta mundet në emër të komisionit në ndër kohë dhe ta sqarojë kryetari i komisionit, konstaton që përderisa është Qeveria në detyrë, proceduralisht nuk do duhej që Kuvendi të miratojë ligje të tilla.

Natyrisht që unë nuk pajtohem me një konstatim të tillë, mirëpo kjo nuk është çështje e një deputeti, duhet të ketë vullnet politik që ligjin që ju e përmendet, ligjin e veçantë për çështjen e pandemisë, ta kalojmë.

Përsëri u bëj thirrje deputetëve, pavarësisht se cilës parti u takojnë, që një nismë të tillë ta përkrahin, sepse duhet urgjentisht të procedohet. Po flas për nismën që një grup i deputetëve do ta procedojmë, besoj qysh nesër, si ligj të veçantë për t'u marrë me çështje të pandemisë.

Zoti Hamza, në qoftë se dëshironi prapë për procedurën e propozimit tuaj.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Bazuar në situatën në të cilën është vendi, bazuar në faktin që këto dy projektligje i plotësojnë kushtet që të trajtohen në seancë. Unë e kuptoj në momente të caktuara që për shkak të situatës së jashtëzakonshme, seanca ka mundësi që të vendos për çështje të caktuara.

Ne, me qëllim që t'i dalim në ndihmë qytetarëve të Kosovës, dhe kjo çështje e tejkalon nivelin e një grupacioni politik, e kalon nivelin e një partie politike, mund të ketë vështirësi Qeveria që të procedojë ligje në Kuvend, po përderisa Kuvendi është funksional nuk ka problem që të marrë nisma ligjore.

Ligjet kanë për qëllim, ne jemi të vonuar në këtë temë, kur dihet që shumica e vendeve i kanë marrë këto masa, dhe veçse janë duke i zbatuar këto masa, dhe realisht nëse këto ligje nuk futen në procedurë dhe nuk aprovohen, atëherë edhe masat e propozuara nga Qeveria, bien ndesh edhe me ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, edhe bien ndesh me ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe bien ndesh edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 65, pika 5.

Ne, po ju lutemi për mirëkuptim dhe kërkojmë që të gjitha grupet parlamentare që t'i fusim në procedurë, t'i diskutojmë, ndërkaq nëse ka propozime të tjera që të plotësohen, të ndryshohen, diçka të hiqet dhe diçka të shtohet, ne jemi të gatshëm.

E dimë se nëse ekziston vullneti politik, nëse ekziston gatishmëria, kjo çështje mund të kryhet shumë shpejt.

Dhe, mbi të gjitha, nuk është Kuvendi ai institucion i cili merret me çështjen e zbatimit të këtyre ligjeve. Ligjet do t'i zbatojë dhe ekzekutimin e ligjeve e bën ekzekutivi, e bën Qeveria, pavarësisht dhe pa paragjykuar se kush do të jetë Qeveri në të ardhmen. Por, në diçka që jam i sigurt, jam i sigurt që bizneset, dhjetëra-mijëra biznese kanë nevojë për ndihmë.

Qindra-mijëra të punësuar në sektorin privat që kanë mbetur pa paga, kanë nevojë për përkrahje. Të gjitha kategoritë që përfitojnë si rezultat apo prej transfereve sociale prej Buxhetit të Kosovës, edhe pensionistët, edhe kategoritë e dala nga lufta, edhe familjet në asistencë sociale, edhe pensionet e pensionistëve të parakohshëm të Trepçës, edhe sportistët, edhe artisët edhe të gjitha kategoritë, kanë nevojë që Kuvendi të jetë në përkrahje të tyre.

Projektligjet të cilat i kemi propozuar nuk shkaktojnë rrëmuje në buxhet, nuk e prekin asnjë projekt brenda buxhetit ekzistues. Janë linja të reja buxhetore dhe shtohen disa lindja, për më tepër e ruajnë edhe ekuilibrin, sepse i kanë burimet e financimit.

I kanë tri burime të financimit që janë më se të qëndrueshme.

Zonja kryetare,

Unë prapë në emër të grupit parlamentar, ju lus juve dhe deputetët e LDK-së, të AAK-së, të Nismës, të Listës serbe, të grupit 6+, edhe deputetët e pavarur, që të hidhet në votim mocioni, të votohet që të futet në rend të ditës për trajtim. Kjo, për shkak se, pa u krijuar baza legale, ne mund të flasim, mund të bëjmë deklarata politike, mirëpo në mënyrë që përfitojnë qytetarët e për të përfituar kategoritë të cilat janë në nevojë, të cilat i përmenda, duke mos përjashtuar edhe ndërmarrjet publike që janë në gjendje jashtëzakonisht të rëndë disa prej tyre, sidomos disa që merren me grumbullimin e hedhurinave e të tjera, unë ju lus që ky mocion të vendoset në votim, dhe i lus deputetët për mirëkuptim që të votojnë që këto dy projektligje të futen në rend të ditës dhe të diskutohen.

KRYETARJA: Lidhur me çështjen në fjalë, mua më duhet që ta lexoj Komentarin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili sqaron që rendi i ditës i seancave të jashtëzakonshme, duhet përcaktuar paraprakisht dhe nuk mund të ndërrohet në seancë.

Prandaj, edhe për shkak të rregullave të tilla, unë nuk mund ta vendos në votim propozimin në këtë seancë. Megjithatë, ju e dini, keni të drejtë si deputetë që ndërmerrni procedura në seancë të re, në mënyrë që ligjet që ju i përmendet të vendosen në votim. Mirëpo, duke e marrë për bazë edhe vet komentuarin e Kushtetutës së Kosovës, sepse kjo është çështje kushtetuese, jo vetëm çështje e Rregullores së Kuvendit, nuk mund ta vendos këtë propozim në votim.

Në qoftë se duan grupet e tjera parlamentare lidhur me propozimin e zotit Hamza, para se të kalojmë te përmbajtja e seancës.

Shkojmë pauzë për 10 minuta, që qoftë se pajtohen grupet parlamentare. Urdhëroni, Grupi Parlamentar i LDK-së, a pajtoheni me propozimin?

ARBEN GASHI: Nëse është e rëndësishme po, mirëpo s'po di pse. A kanë nevojë që të konsultohen? Po more, 10 minuat pauzë, le të konsultohen.

KRYETARJA: A pajtohen grupet e tjera parlamentare? A ka ndonjë kundërshtim? Atëherë, 10 minuta pauzë në pajtim me të gjitha grupet parlamentare që janë prezent.

Po, po natyrisht që ua jap fjalën, askujt nuk ia ndalojmë, vetëm çështja është që për propozim, vet propozuesi kërkoj pauzë. Në qoftë se jeni kundër pauzës, nuk ka kurrfarë problemi. Nuk jeni kundër. Në rregull, 10 minuta, besoj mund të konsultoheni dhe pastaj vazhdojmë.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës)

KRYETARJA: Kemi kuorum të mjaftueshëm, vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gazmend Abrashi. Mund të vini te foltorja këtu.

Fillimisht z. Hamza e ka fjalën në emër të propozuesit.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, znj. kryetare!

Edhe pse ishim të sigurt në atë që kërkonim, po megjithatë dëshiroj shumë që ta faktojmë, që ky Kuvend në të kaluarën, ka pasur raste kur në seanca të jashtëzakonshme, ku para se të kalohet në pikën e cila ka qenë, është futur në rend të ditës ligj i caktuar, siç është rasti me seancën e mbajtur më 27 qershor 2019, ku ka kaluar dhe është miratuar ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

Ky është vetëm një rast, por ka edhe raste të tjera. Nuk ka situatë më të rëndësishme se kjo, kur ky Kuvend mund të diskutojë dhe t'i fusë në procedurë dy projektligje, të cilat janë të domosdoshme për situatën aktuale në të cilën është vendi.

Ne po e shohim gjendjen në Veri, edhe po shohim se çka është krijuar me gjendjen në veri, si është duke u vepruar me gjendjen në Veri. E kam edhe një lutje, po edhe një kërkesë, po është edhe deklaratë e Grupit Parlamentar të PDK-së, ne po insistojmë, duke u bazuar edhe në fakte, duke u bazuar edhe në nevojën, duke u bazuar në pritjet dhe nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës për përkrahje dhe ndihmë, që të futet në votim mocioni procedural.

Në të kundërtën e kësaj, Grupi Parlamentar i PDK-së, nuk do t'i përkrahë iniciativat e tilla në të ardhmen. Prandaj, po ju lus, sepse po flasim për dhjetëra-mijëra biznese, po flasim për qindra-mijëra të punësuar në sektorin privat të cilët presin ndihmë dhe kanë mbetur pa paga ata edhe familjet e tyre.

Po ashtu, po flasim për 260 mijë persona që realizojnë pagesa prej Buxhetit të Kosovës në emër të transfereve sociale, po sigurojmë që asnjë veprim duke e respektuar ligjin, pa ligj mund ta pa bëjmë, por shkelet edhe Kushtetuta e lëre më ligji, veç nëse respektohet ligji i Buxhetit, nëse respektohet ligji i Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ku është nen i veçantë, i cili flet për deficitin buxhetor, ku është nen i veçantë, i cili flet për bilancin bankar dhe nëse

s'respektohet Kushtetuta, asnjë Qeveri cilado qoftë ajo, nga kushdo qoftë e udhëhequr, nuk mund të zbatojë pako të përkrahjes financiare për rimëkëmbjen e ekonomisë, pa ardhur në Kuvend dhe ta krijojë bazën legale.

Prandaj, qëllimi ynë është, jo të humbasim kohë këtu dhe të mos jemi produktiv, po të kalojmë direkt në çështje konkrete, t'i procedojmë projektligjet. Nëse në të kaluarën ka pasur hapësirë dhe është mirë që ka ndodhur, ka hapësirë edhe sot.

Nëse duam të jemi rixhid, nuk duam të jemi bashkëpunues, nuk duam t'i adresojmë nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, për çka jemi të detyruar edhe përgjegjës, ne mund të gjejmë elemente të ndryshme, po realisht janë pabazuara, janë në kundërshtim me procedurat dhe praktika që kanë ndodhur edhe janë në kundërshtim edhe me interesin e qytetarëve të Kosovës.

Ne po e shohim që Qeveria aktuale, realisht merr masa, pra Qeveria e shkarkuar merr masa, merr vendime që i cenojnë edhe ligjet edhe Kushtetutën. Kemi thirr dhe vazhdojmë të thërrasim pozitën prej pozicionit të opozitës për konsensus të brendshëm, dhe sot po e kërkojmë, mirëpo në të ardhmen nëse kërkohet prej nesh, atëherë sigurisht që edhe ne nuk kemi mundësi që t'ia japim përkrahjen iniciativave të caktuara.

Prandaj, znj. kryetare, po ju lus që ta hidhni në votim mocionin procedural për futjen në procedurë të dy projektligjeve. Tekefundit janë tema për të njëjtën çështje, veç dallimi është që me ligje bëjmë punë konkrete edhe hapim mundësi që t'ju ndihmohet qytetarëve të Republikës së Kosovës, bizneseve të të gjitha kategorive.

Ndërsa, tema e propozuar me rezolutë, është një dokument për të cilin mund të diskutojmë, po nuk prodhon efekt legal. Prandaj, po ju lus që bazuar në këtë që e thashë, bazuar në dokumentet, bazuar në procesverbalet e seancave nga e kaluara, ta hidhni në votim propozimin e Gripit Parlamentar të PDK-së. Faleminderit!

KRYETARJA: Zoti Abrashi e ka fjalën, dhe pastaj kur të përfundojnë në emër të grupeve, do t'ju përgjigjem lidhur me propozimin tuaj. Urdhëro z. Abrashi, përgatitet z. Limaj.

GAZMEND ABRASHI: Faleminderit, kryetare!

Grupi Parlamentar i Aleancës kërkon mocion për ndryshim të plotësimit të ligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, që përfshinë pakon emergjente, gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e Kosovës, sipas propozimit të Aleancës, 100 euro për secilin qytetar të Kosovës.

Dhe e dyta, pakon e stabilitetit në vlerë prej 210 milionë eurosh.

Mendoj që ky Kuvend e ka legjitimitetin e plotë për votimin e këtyre projektligjeve. Faleminderit!

KYETARJA: Zoti Limaj, po! Zoti Gashi, sepse nuk ka folur ende Grupi Parlamentar i LDK-së, dhe besoj që derisa të zbrisni ju poshtë e përfundon.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së,

Ju po i referoni një rasti specifik, i cili përbën shkelje të procedurës dhe rregullave të Kuvendit.

Andaj, mendoj se duhet ta keni parasysh këtë element dhe mbi bazën e një shkeljeje, ne nuk mund ta bëjmë shkeljen e dytë.

Sa i përket mënyrës së funksionit edhe idesë për të aprovuar ligje, me dëshirën shumë të madhe dhe me mirëkuptimin për propozimet tuaja dhe për mundësimin të diskutimit të këtyre propozimeve, mund të them se keni probleme procedurale dhe logjike në këtë sistem.

Pra, ne kemi një seancë të thirrur me një rend të ditës dhe rendi i ditës së seancës është: Shqyrtimi i draft-rezolutës së propozuar nga deputetët nënshkrues.

Ne e kemi atë çështje që do ta trajtojmë sot, dhe mbi bazën e diskutimeve japim kontributet tona dhe në fund ndoshta merremi vesh për një rezolutë të përbashkët ose nuk merremi vesh, varet se çka prodhon Kuvendi.

Sa u përket nismave ligjore, ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe në Kryesinë e Kuvendit. Kuvendi ka të drejtë që t'i marrë dy nisma ligjore, nismën për të hartuar një projektligj dhe nismën për t'i kërkuar Qeverisë hartimin e projektligjit.

Dhe, këtu në këtë rast e kemi një problem. Problemi i parë ka të bëjë me faktin dhe sistemin i cili është ndërtuar në Kosovë. Sistemi ynë kërkon që çdo projektligj i cili kalohet në Kuvend, shkon për mendim në Qeveri. Jo domosdoshmërisht mendimet e Qeverisë zbatohen në Kuvend.

Kur projektligji shkon për mendim në Qeveri, nëse është nismë e Kuvendit, atëherë Qeveria e ka një muaj që të përgjigjet. Nëse është nismë që t'i kërkojë Qeverisë hartimin e projektligjit, Qeveria i ka tre muaj që të përgjigjet, dhe në këtë rast ne e kemi një problem tjetër, Qeverisë ia kemi heq besimin. Qeveria nuk ka të dejtë që t'i përgjigjet Kuvendit, po ashtu nuk ka të drejtë që t'i propozojë Kuvendit.

Pra, ne e kemi një marrëdhënie të ndërprerë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe këtu e kemi një problem shtesë lidhur me atë që po propozoni ju.

Ju po propozoni që të plotësohet apo të ndryshohet projektligji për ndarjet buxhetore. Plotësimi apo ndryshimi i projektligjit për ndarjet buxhetore, si e drejtë themelore e Qeverisë, nuk mund të bëhet nga Kuvendi në bazë të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2013, rasti i Vetëvendosjes, ku atakon vendimin e Qeverisë për fondin për Veriun, ku thotë se buxheti përcaktohet nga Qeveria.

Pra, kur të vjen në Kuvend, Kuvendi e amendamenton e ndryshon e plotëson e refuzon krejt, po nismë si të tillë, ka të drejtë ta bëjë Qeveria. Pra, po hyjmë në një situatë, ku realisht nuk prodhojmë asgjë pozitive.

Unë e kuptoj vullnetin tuaj. E kuptoj se shoqëria, kategoritë sociale, ekonomia dhe bizneset kanë nevojë për përkrahje, dhe këtu plotësisht pajtohem me juve që ka nevojë për përkrahje, dhe patjetër që ne duhet ta strukturojmë përkrahjen tonë, dhe në atë që ne e parashohim si LDK, për të cilën normalisht që duhet ta gjejmë konsensusin politik në Kuvend, për të cilin unë nuk preferoj gjuhën, se ju nuk po na ndihmoni sot dhe ne s'do t'ju ndihmojmë nesër, mirë është që ta gjejmë rrugën e zgjidhjes.

Mendoj se rruga e zgjidhjes është se ne duhet ta trajtojmë këtë çështje në dy shtylla. Shtylla e parë ka të bëjë me ndërhyrjen emergjente, si te kategoritë social, si te kategoria e ekonomisë apo e bizneseve. Ndërkaq, shtylla e dytë ka të bëjë me rimëkëmbjen ekonomike pas kalimit të fazës emergjente.

Andaj, këto duhet t'i diskutojmë bashkë, t'i trajtojmë me të gjithë, edhe me Vetëvendosjen, e cila mund të mos jetë ose mund të jetë prapë nesër në pushtet, me juve me secilin deputet, me cilindo që ka ekspertizë dhe mund të japë kontribut në këtë fushë. Mirëpo, janë çështje shumë të ndjeshme.

Pra, nuk mundemi të ndërtojmë në një relacion mbi bazën e kushtëzimit, sepse ne e kemi një kushtëzim sot, e kushtëzimi kryesor është prej Qeverisë. Qeveria ka marrë autoritetin dhe përgjegjësitë e Kuvendit. Qeveria në një formë e ka suprimuar Kuvendin. Ka shpallë gjendje të jashtëzakonshme, ka kufizuar liritë dhe të drejtat e njeriut. Ka kufizuar linë e lëvizjes së deputetëve e që janë veprime të palogjikshme dhe të paarsyeshme.

Pra, ne po e dimë ku e kemi problemin. Kosova e di ku e ka problemin. Kjo shoqëri, ky Kuvend, pra shumica e popullit të Kosovës, 2/3 mbi 2/3 e popullit të përfaqësuar në këtë Kuvend, e di se ku është problemi. Problemi është Qeveria, sepse nga një Qeveri në detyrë është shndërruar në një Qeveri në uzurpim.

Kryeministri e ka një letër prej presidentit, ku i kërkon që të marrë përsipër formimin e Qeverisë dhe ai duhet të përgjigjet, ose e merr ose refuzon që ta marrë, në mënyrë që hapet rruga.

Pastaj një Qeveri e re, cilado qoftë ajo, mund të jetë prapë Qeveri e Vetëvendosjes, mund të jetë Qeveri e Vetëvendosjes me partnerë të tjerë, Qeveri gjithëpërfshirës, nuk mund të paragjykoj se çfarë Qeverie mund të jetë, po një Qeveri e re që mund të vi, mund të marrë vendime të reja.

Kjo janë çështje që do të ndikojnë në ekonominë e Kosovës për disa vite, nuk flitet vetëm për pak ditë. Kjo do ta rrisë borxhin publik. Kjo do t'i fusë edhe gjeneratat e reja në borxh, varet se sa thellë do të shkojë problemi.

Pra, nuk është çështje që merret në një sistem të kushtëzimit që po e bën Qeveria apo me një veprim të ngutshëm ndoshta prej të tjerëve prej vullnetit të mirë.

Duhet të jemi të kujdesshëm që ta ruajmë një sistem juridik që e ka vendi. Ne e kemi një organizim kushtetues dhe juridik. Ky vend e ka një sistem sesi reagon në gjendje të jashtëzakonshme. E ka Këshillin e Sigurisë Kombëtare, i ka institucionet e veta që reagojnë. Sigurisht, edhe për gjenden e emergjencës shëndetësore e cila nuk është shndërruar ende në gjendje të jashtëzakonshme, po ashtu i ka parashikimet e funksionimit.

Çka neve na duet tani, është përgjegjësi institucionale. Ruajtja e sistemit juridik, ruajtja e trupit të jetës dhe të shëndetit të qytetarëve të Kosovës, ruajtja e shëndetit të ekonomisë dhe mundësisht krijimi i kapaciteteve që të reduktohet sa më shumë që është mundur gotikja ekonomike e cila pritët të vijë.

Këtij vendi po pritët t'i vijë një goditje ekonomike, siç do t'i vijë e gjithë botës, dhe kjo duhet të parandalohet. Këtu duhet të merren veprime dhe këto veprime nuk janë veprime që i merr i dikush duke thënë, sot duhet të bëhet se s'bën nesër. Pra, janë veprime afatgjata.

Ne e kemi një problem që është problem politik. E kemi një Qeveri në dorëheqje e cila i ka për detyrë që t'i ushtrojë disa autorizime funksionale, Ndërkaq, ajo Qeveri vazhdon që vetëdijshëm ta skelë Kushtetutën, vazhdon që vetëdijshëm ta përmbysë sistemin e rendit juridik në këtë vend, dhe ne nuk po merremi me këtë problem. Ky është problemi kryesor.

Problemin kryesor që e ka kjo shoqëri sot, ka ndodh një përmbysje e rendit juridik dhe kushtetues. Këtu duhet ta kthejmë rendin juridik dhe kushtetues dhe të ulemi bashkërisht që të shohim se cilat janë veprimet ekonomike. Nëse aq shumë është duke i dhembur zemra kryeministrit në detyrë se çfarë është duke ndodhur, pse nuk e merr përgjegjësinë. Pse s'e merr përgjegjësinë?

Nëse ne të gjithë po themi që, problem është shëndeti i qytetarëve, siguria publike, zhvillimi ekonomik, rreziku i rënies ekonomike, dhe të gjitha këto, pse s'po ulemi që të merremi vesh?

Institucionet legjitime t'i marrin vendimet e veta. Pse duhet të gjenden rrugë të dyshimta juridike që të ndërmerren veprime? I kemi institucionet. Ne jemi pajtuar për këtë rend kushtetues.

Në momentin që e kemi aprovuar këtë Kushtetutë, jemi pajtuar për këtë rend juridiko-kushtetues, s'kemi nevojë që ta tejkalojmë. Nëse çështja është e rrezikshme, atëherë e kemi Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Nëse rreziku është më i ultë, atëherë e kemi Ministrinë e Shëndetësisë. Nëse Kuvendi nuk i beson kësaj Qeverie që të funksionojë, atëherë i jepet mundësia që të ripropozojë partia e parë, ose të propozojnë partitë tjera.

Pra, ky është një rend, këtë rend duhet ta respektojmë dhe mbi bazën e këtij rendi pastaj t'i marrim veprimet e duhura, sepse janë veprime me ndikim afatgjatë, dhe veprimet me ndikim afatgjatë duke i futur në borxh edhe gjeneratat, duhet të konsultohen pak, të konsolidohen dhe të dalim me bindje në veprime tona që i marrim.

Pa dashur t'i gjykoj propozimet tuaja, nuk jam duke u marrë me pjesën përmbajtjesore, sepse për pjesën përmbajtjesore me siguri kemi për ta diskutuar, dhe sigurisht që do të pajtohemi po edhe të mos pajtohemi në shumë gjëra, që është normale, ngase jemi parti të ndryshme, kemi këndvështirime të ndryshme dhe i shohim ndryshe zgjidhjet.

Po flasim për çështjen procedurale dhe logjikën institucionale. Ka një logjikë institucionale që duhet të respektohet, dhe thirrja ime dhe e LDK-së është që të respektohet kjo logjikë institucionale që të mos kemi përmbysje të rendit kushtetues dhe të logjikës institucionale nga Qeveria e cila është shkarkuar, e cila del dhe thotë, unë flas në emër të popullit.

Ne e dimë forcën relative gjithsecili sa e kemi; 25 % Vetëvendosja, 25 % LDK-ja, 22 apo 23 % PDK-ja, e kështu me radhë.

Ne për ta përfaqësuar popullin duhet të bashkohemi, për të pasur një demokraci funksionale mbi gjysma, sot është 1/4.

1/4 sepse i është hequr besimi i këtij Kuvendi.

Pra, na duhet një konsensus më i gjerë, një mirëkuptim më i gjerë dhe i një vullnet më i mirë që të arrimë që t'i tejkalojmë këto probleme. Faleminderit!

KRYETARJA: Po, replikë Bedri Hamza!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetare!

E para, iniciativa e PDK-së është tërësisht e bazuar në ligj dhe në procedurë.

Nuk ishim ardhur fare në këtë pikë sikurse Qeveria, tashmë në dorëheqje të kishte pasur vizion dhe sikur të kishte përvojë. Edhe aprovimi i buxhetit kur ka ndodhur, që ka ndodhur i trafikuar dhe në mënyrë klandestinë t'i parashihte këto situata, sot s'do të kishim pasur nevojë që të humbim kohë fare.

Mirëpo, nuk ka dallim shumë prej situatës kur është aprovuar buxheti edhe asaj që është sot. Edhe atëherë ka pasur raste të konfirmuara me virusin Covid-19, në Kosovë. Sidoqoftë, ne duke e respektuar procedurën, kemi marrë iniciativa ligjore, i kemi proceduar tutje në administratën e Kuvendit, sot kemi ardhur në seancë, po kërkojmë mocion procedural, një diçka që ka ndodhur edhe në të kaluarën dhe normalisht që jemi insistues në këtë pikë, sepse kemi qëllim të prodhojmë situatë legale, ku realisht mund t'ju ndihmojmë njerëzve të cilët kanë nevojë.

Prandaj, po e kërkojmë mirëkuptimin e të gjitha grupeve parlamentare që ta përkrahin këtë mocion, të futen këto ligje në procedurë, dhe pastaj sa i përket përmbajtjes, po more jemi të hapur që ta diskutojmë.

Çdo ide që është e mirë dhe kontribuon pozitivisht, jemi në rregull. Çdo gjë që është e tepërt, jemi të hapur që ta diskutojmë, mirëpo nëse s'krijohet baza legale, prapë e them, do të ketë deklarata politike, ruana Zot ka edhe të atillë që s'pyesim fare as ligj as Kushtetutë, veç duke e respektuar ligjin dhe Kushtetutën, pa u krijuar baza legale nuk do të mund të përfitojnë qytetarët e vendit nga përkrahja ekonomike dhe financiare.

Prandaj, ky është qëllimi ynë dhe kjo është kërkesa jonë.

KRYETARJA: Zoti Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: E nderuar kryetare e Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga momenti i prezantimit ose i propozimit të propozuesit për këtë seancë dhe deri sot në mbajtje, kanë ndodhur zhvillime të jashtëzakonshme në vend.

Unë besoj që një pjesë, nëse nuk gabo, pak e hapi kryetarja e Kuvendit, disa tema, e që ne si deputetë duhet para së gjithash, zhvillimeve të fundit që kanë ndodhur t'ju japim një kujdes të veçantë si Kuvend i Kosovës.

Institucioni më i lartë i Republikës së Kosovës, të cilit i ka bërë thirrje Gjykata Kushtetuese që t'i shfrytëzojë kompetencat e veta, praktikisht edhe njëherë dje, është suprimuar ose kemi një ndërhyrje të vrazhdë në kompetencat e Kuvendit nga Qeveria në ikje. Për mendimin tim, në aspektin legal është situatë e jashtëzakonshme ajo që ka ndodhur dje, në aspektin legal.

Duke mos mohuar propozimet, idetë, rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, duke e ndarë këtë pjesën humanitare shëndetësore dhe nevojave për të marrë masa, ne jemi të obliguar që të gjitha këto masa të jenë në përputhshmëri me ligjin, në respekt të ligjit dhe Kushtetutës.

Sot bota ka një debat të madh, luftën kundër pandemisë në suaza të kornizave ligjore dhe kushtetuese të vendeve përkatëse. Në fakt ajo që ka ndodhur dje, e posaçërisht jep alarm për përsëritjen e shkeljes së Kushtetutës, bile tash edhe një hap më tutje, shumë më vrazhdë se herën e kaluar, unë jam i trishtuar me mosreagimin e shumë institucioneve të cilat e kanë për obligim dhe paguhen nga vendi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Kosovës.

Ajo që ka ndodhur dje nuk është kufizim i lirive të qytetarëve të Kosovës, ajo që ka ndodhur dje është suspendim është marrje është grabitje t të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Me një vendim administrativ dhe arbitra ka suspenduar kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, një institucion i cili nuk e ka më legjitimitetin e Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, unë besoj znj. kryetare, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të ndërhyrjes në kompetencat tona të Kuvendit, ne si Kuvend do duhej që sot të dilnim me disa rekomandime për vetën tonë; a jemi ne Kuvendi i Republikës së Kosovës? A duam që t'i ushtrojmë detyrat tona me Kushtetutë? A duhet edhe a kemi obligim që ta mbrojmë rendin ligjor dhe kushtetues të këtij vendi?

Si të adresohet vendimi antikushtetuese, për të cilin ne besojmë që është në kundërshtim me Kushtetutën? A duhet këtë vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ne si Kuvend si grup deputetësh, si Kuvend në tërësi, t'i adresohemi Gjykatës? A kemi të drejtë në çështje konkrete që ne t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese? A duhet ta ftojmë Avokatin e Popullit, i cili zgjidhet këtu nga ky Kuvend që ka ekskluzivisht punë të tij, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, siç e përcakton Kushtetuta?

Në fakt, këto janë tema të cilat do duhej që të trajtoheshin para se të hyjmë në çështjet për të cilat jemi ftuar, për shkak të situatës së jashtëzakonshme dhe jo për dëshirën tonë. Pra, tua japim një përgjigje qytetarëve të Kosovës dhe jo ta lëmë debatin publik medial.

Kuvendi i Kosovës do duhej dhe duhet të flet për situatën e krijuar, për faktin se jemi mbledhur.

Ndoshta ka qenë mirë që në zyrën e kryetares Kuvendit, Komisioni i Ligjeve, shefat e grupeve parlamentare, të ulen e të bisedojnë ngase Kuvendi duhet t'ua japë një përgjigje qytetarëve të vendit.

A e dini se çfarë telashesh sot kanë institucionet e tjera? Sot, polici i Kosovës frikësohet që e shkel ligjin. Ka plotë organe të Republikës së Kosovës të cilat kanë dilema në zbatimin vendimeve nesër.

Natyrisht, mirë është që ne si Kuvend, t'i japim një përgjigje kësaj situate, dhe po e qartë, e duhet ta themi gjithmonë që askush dhe asnjë institucion tjetër, nuk mund t'i kapë kompetencat e institucionit tjetër, në këtë rast, Kuvendit të Kosovës si organi më i lartë.

Çështje tjetër, gjithashtu për të cilën sot unë kam dashur ta ngriti është lëvizja e deputetëve. E dëgjova sqarimin e kryetares së Kuvendit. Në këtë rast, znj, kryetare ju e keni përgjegjësinë më të madhe për faktin që ju jeni atje kujdestare e të drejtave të funksionimit të Parlamentit dhe të drejtave ose detyrimeve të deputetëve.

Ju e dini që ne, deputetët e Parlamentit të Kosovës... dhe mendoj që ju do ta gjeni rrugën që të adresoni atje ku duhet çështjen e komunikimit dhe lëvizjes dhe funksionimit të Kuvendit. Për këtë temë, unë nuk e kam asnjë dilemë. Por, logjika, mënyra që me një akt administrativ një zyrtar i shkarkuar të vendosë sesi duhet të sillemi me vendin, kjo është alarmante.

Po e përmbylli me temën për të cilën u ngritë debati. Këtu, çfarë unë po shoh deri më tani nga debatet që patën dy grupet parlamentare, duke e marrë parasysh edhe atë që e thatë ju në fillim, unë kërkoj edhe një pauzë, që shefat e grupeve parlamentare edhe për këtë temë, të ulen, sepse këtu kemi probleme procedurale.

Pra, kemi problemi ligjore për të cilat është mirë që ulen t'i trajtojnë mirë edhe të dalin me një qëndrim edhe për këtë temë, mirëpo ta shfrytëzojmë rastin edhe për temat të cilat i ngrita unë më parë. Cila është përgjigje, a guxon Kuvendi të heshtë në atë që ka ndodhur dje, e që duhet të futet në veprim nesër? Si do të jetë përgjigjja e Kuvendit të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARJA: Një sqarim, meqenëse edhe m'u drejtuat z. Limaj, edhe shpresoj në mirëkuptimin e deputetëve që po flas nga ky mikrofon, qëllimi i vetëm është që të mos përdoret foltorja nga shumë njerëz.

Përfaqësuesi i grupit tuaj parlamentar, nuk më kujtohet se a ka qenë prezent në mbledhjen e fundit të Kryesisë, nuk ka qenë, mirëpo ne e kemi trajtuar në mënyrë të veçantë, si pikë të veçantë të rendit të ditës, atë ditë në Kryesi, obligimin e Kuvendit të Kosovës, që pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të nxjerr ligj të veçantë, i cili pastaj autorizon kufizimin e të drejtave të njeriut.

I kam njoftuar të gjitha grupet parlamentare, që mendimi im si kryetare e Kuvendit është që urgjentisht të procedojmë me një ligj të tillë në Kuvend, sepse kjo do të eliminonte pastaj çdo

problem procedural, ligjor, kushtetuese, e sidomos e kam përmendur njëjtë sikur ju, çështjen e rolit të policisë, organeve të rendit të cilëve ju duhen qartësi.

Ka pasur grupe parlamentare që nuk kanë dalë kundër, por ka pasur grupe parlamentare që kanë dalë kundër. Përfundimisht, nuk është përkrahur propozimi im që atë ditë ta bëjmë një grup punues, i cili brenda javës do ta sillte në këtë Kuvend, ligjin e veçantë për Pandeminë, i cili pastaj do t'i trajtonte të gjitha kufizime të të drejtave të njeriut dhe sot nuk do të kishim pasur nevojë që të flasim për këtë temë fare.

Meqenëse, nuk është pranuar ai propozim, pastaj kemi gjetur mundësi të tjera, ndër të tjera kemi kërkuar mendimin e Komisionit për Legjislacion, i cili sot na e ka sjellë mendimin e tyre, të cilin pak më herët e përmenda në këtë seancë, pra që proceduralisht mendimi i tyre apo i shumicës në komision është që të mos procedohet me ligj të Kuvendit.

Megjithatë, unë mendoj që si deputetë të Kuvendit të Kosovës, ne e kemi obligim që urgjentisht ta iniciojmë këtë ligj. E dinë anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare, që qysh atë ditë i kam njoftuar që ka ekspertë, profesorë të të drejtës kushtetuese që e kanë ofruar të gjithë ndihmën e tyre, që për 24 orë ta bëjnë këtë ligj.

Prandaj, që meqenëse në Kryesi nuk ka pasur një konsensus, dhe ju e dini që pa e pasur vullnetin e grupeve politike, unë kot e thërrasë seancën, meqenëse nuk ka pasur një konsensus të tillë.

Unë do ta procedojë një draft qysh nesër, por sipas të gjitha procedurave që janë të parapara në Rregullore të Kuvendit dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, si nismë legjislative, e hartuar nga ekspertët, në përputhje të plotë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, që në qoftë se ka vullnet politik, për pak ditë vendoset në rend të ditës së këtij Kuvendi dhe eliminon çdo paqartësi ligjore kushtetuese.

Natyrisht, mirëpriten pastaj komentet e të gjitha grupeve parlamentare. Secili grup ka ekspertë të këtyre fushave, plotësohet, ndryshohet. Mendimi im është që duhet pastaj në një seancë të rregullt, në procedurë të përshpejtuar të votojmë për shmangie dhe brena javës ta kemi atë ligj që më të mos diskutojmë në debatet të tilla, kur, siç u tha edhe më herët, do duhej që shqetësimi kryesorë të ishte shëndeti i qytetarëve dhe si t'i eliminojmë barrierat e jo si të krijohen barrierat e tjera.

Pra, nuk është që unë nuk i kam ndërmarrë hapat e nevojshëm deri tash. Kam diskutuar me ministritë përkatëse, me komunat përkatëse, se cilat janë problemet ligjore që kanë hasur në mënyrë që, ne si Kuvend i Kosovës t'i eliminojmë ato. Por, një gjë duhet ta kemi të qartë, autoritet e Kuvendit s'mund t'i suprimojë askush, ato janë të përcaktuar me Kushtetutë. Ato mund të preken vetëm kur preket Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Përderisa ky Kuvend nuk është shpërndarë, rruga më e mirë është që ne brenda pak ditësh, në përputhje të plotë me procedurat e parapara në Rregullore, ta kalojmë ligjin e veçantë, ashtu siç edhe kanë propozuar edhe siç e ka mbështetjen në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, edhe ta gjejmë një tekst duke e marrë bazë shembuj të mirë nëpër Evropë, dhe ta kalojmë shpejtë e shpejtë që të mos kemi më, asnjë problem, sepse ata që më shumti pastaj kanë probleme në terren, janë në radhët të parë organet e rendit, e pastaj për shkak të moszbatimit apo mosrespektimit të masave, problemin final e kanë edhe qytetarët tanë edhe profesionistët shëndetësorë.

Kjo, sa për ta sqaruar lidhur me veprimet që janë ndërmarrë deri tani. Unë shpresoj që edhe pse s'ka qenë përfaqësuesi i grupit tuaj atë ditë në Kryesi, që një nismë të tillë do ta përkrahni, në mënyrë që të eliminohet çdo paqartësi ligjore e kushtetuese, dhe të rikonfirmohet roli i Kuvendit në këtë proces, ashtu siç e ka propozuar edhe Gjykata Kushtetuese.

A dëshironi fjalën? Jo! Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në fakt ne e kemi trajtuar sot në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion shkresën tuaj. Në fakt interpretimi ynë nuk është ashtu siç thoni ju.

Interpretimi ynë është që Gjykata me aktgjykimin e saj, i ka dhënë kohë Qeverisë dhe Kuvendit deri më datën 13, që eventualisht të ndërmarrë masa, nëse vlerëson që me ligj dëshiron t'i kufizojë liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.

Gjykata ka ardhur në përfundim që sjellja e Qeverisë, e kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut siç ka veprua, ka shkelur Kushtetutën.

Thotë, ju i keni në dispozicion kaq kohë, nëse vlerësoni ju që duhet të nxirret në ligj të ri. Përndryshe, kalon në nenin 56, ku flet për shmangien e lirive dhe të drejtave të njeriut e që bëhet në rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme.

Përpjeka ose interpretimi që po e bëni ju, është përpjekje që të legjitimohet sjellja e kësaj Qeverie, duke e lënë anash nenin 56, i cili...

KRYETARJA: Zoti deputet, je duke keqpërdorë duke i dezinformuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk ke asnjë të drejtë. Në radhë të parë, fjalën ta dhashë... Ndaluni ju!

Fjalën, ta dhashë që të flasësh për çështjen e mocionit. Në qoftë se dëshiron të flasësh për çështjen e mocionit, fol. Në qoftë se flet për një temë tjetër, regjia ia ndalni menjëherë fjalën.

DRITON SELMANAJ: E para, kjo qasje autoritare e juaja po më ngjan me dikë tjetër, po ju me juve personalisht.

KRYETARJA: Regjia, ndaljeni fjalën deputetit. Faleminderit shumë!

Kush tjetër e ka kërkuar fjalën, lidhur me mocionin, asgjë tjetër. Zoti deputet, në qoftë se mendon që të është shkelur ndonjë e drejtë, janë procedurat.

Po e lexoj mendimin e Komisionit për Legjislacion. Komisionit për Legjislacion, Kryesia e Kuvendit, nuk i ka kërkuar të interpretojë veprimet e Qeverisë, sepse atë interpretim e ka bërë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Komisionit për Legjislacion, i është kërkuar që të identifikojë të gjitha masat që duhet t'i ndërmarrë Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Shkresa që unë e kam marrë sot nga ju dhe për të cikën ju i gënjeni qytetarët se kinse po dezinformoj, thotë:

1. Aspekti formal, kjo për faktin thotë Komisioni për Legjislacion, se tani kemi një Qeveri në dorëheqje dhe Kuvendi i Kosovës nuk mund të nxjerrë ligje. Thotë që Kuvendi i Kosovës nuk mund të nxjerrë ligje. Ju e kenë thënë këtë.

Kështu që, në momentin që ju më ofendoni mua në këtë seancë, siç më ofenduar pak më herët, natyrisht që unë ua ndali fjalën. Nuk ta jap fjalën që të ofendosh. Shefi i grupit parlamentar ka të drejtë që ta marrë fjalën, po ofendimet nuk ia lejojë askujt hiq. Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetare!

Mendoj se është bërë një shkelje procedurale, duke iu mohuar e drejta e fjalës, deputetit Selmanaj, po flas si kryetar i grupit, sepse prej fillimit të seancës ne jemi duke folur jo për rendin e ditë, meqë vet propozuesi e ka ndryshuar propozimin, e para.

E dyta, z. Limaj ka folur komplet për diçka tjetër, ka kërkuar prej jush, ju keni fol disa herë dhe keni dhënë përgjigje për çështje që nuk janë në rend të ditës, ndërsa deputeti Selmanaj, si kryetar i Komisionit për Legjislacion, duke folur për çështjen konkrete që ka të bëjë me gjendjen emergjente dhe me masat e ndërmarra, ka plotësisht të drejtë që ta ketë fjalën e tij dhe ta japë mendimin e tij, po edhe mendimin e komisionit.

Në këtë rast, deputeti Selmanaj ka qenë duke folur si kryetar i komisionit.

Prandaj, ju lus që të respektohen rregullat, të respektohet gjuha parlamentare dhe të jemi në korrekt në vendimet të cilat merren. Pra, kërkoj nga ju që t'ia jepni fjalën deputetit Selmanaj, dhe të vazhdojë në mënyrë të rregullt si kryetar i komisionit. Faleminderit!

KRETARJA: Unë në fakt, në momentin kur bëhet një propozim për mocion procedural nuk kam asnjë obligim me Rregulloren, siç u sqarua edhe me nënkryetarin, që tua jap grupeve të tjera. Ishte vetëm vullneti imi i mirë që t'i dëgjojmë grupet për propozimin për mocion procedural.

Megjithatë, po e sqaroj edhe njëherë. Po kthehem te propozimi i z. Hamza, i cili e përmendi një shembull të mëhershëm të Kuvendit të Kosovës, ku në seancë të jashtëzakonshme është fut edhe një pikë e rendit të ditës.

Megjithatë, për shkak të Komentarit të Kushtetutës, të cilin e lexova më herët, unë nuk mund ta vendos interpretimin apo praktikën e seancave të mëhershme, të cilat kanë përbërë shkelje të procedurave përmbi interpretimin e Kushtetutës së Kosovës. Ky interpretim kërkon nga unë që të mos e vendos këtë mocion në votim.

Megjithatë, meqenëse u propozua edhe nga të tjerët, kryetari të Komisionit për Legjislacion ia dhashë fjalën për të folur për mocionin. Nuk ka pasur interesim që të flasë për mocionin, por e shfrytëzojë atë për të më ofenduar mua.

Deputetët e tjerë nuk më ofenduan, prandaj edhe nuk pati asnjë nevojë që dikujt t'ia ndal fjalën. Në momentin që më ofendon, cilido deputet i Kuvendit të Kosovës, nuk ka nevojë që të vazhdojë.

Komisioni për Legjislacion e ka dërguar opinion e vet me shkrim, të cilin unë e lexova. Nuk ka asnjë dezinformim, e lexova fjalë për fjalë se çfarë ka shkruar Komisioni për Legjislacion. Po, është vendim i shkruar, nuk ka dezinformata e as më pak të thuhet, ti po bën si këta e ti po bën si ata. Nuk ka nevojë që të shkohet në ofendime, z. deputet.

Kushdo që dëshiron të flasë tani për pikën e parë të rendit të ditës.

Zoti deputet, ju që po e kërkon fjalën. Për mocionin ia kam dhënë fjalën vetëm përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Edhe pse nuk është praktikë, ju lejova që të flisni për mocionin, mocionin e zotit Hamza.

Secili deputet, nuk ka të drejtë që të flasë për mocionin, ai mocion vendoset ose nuk vendoset në votim. Meqenëse, është në kundërshtim të plotë me interpretimin e Kushtetutës, unë nuk mund ta vendos për votim. Por, deputetët kanë çdo të drejtë që në mënyrë urgjente të kërkojnë trajtimin e ligjeve.

Po e përsëris, unë pajtohem me secilin interpretim që ka ligje që duhet të trajtohen urgjent në këtë seancë, por për fat të keq, nuk kam të drejtë kushtetuese që në këtë seancë, të kërkuar nga ju, ta vendos si pikë të rendit të ditës.

Procedurat ekzistojnë, në momentin që respektohen, unë do ta thërrasë atë seancë.

Nga shefat e grupeve kemi dëgjuar për mocionin. Prandaj, po procedoj me pikën e vetme të rendit të ditës,

1. Propozimi dhe miratimi i masave konkrete ekonomike e financiare të propozuara nga 48 nënshkruesit

Urdhëroni edhe një herë për herë të fundit para se të procedojmë, z. Hamza!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, znj. kryetare!

Qëllimi i propozimit është që ne të krijojmë bazën legale që nëpërmjet ligjit, t'ju mundësohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës, Kuvendi të krijojë bazën legale për t'i ndihmuar mbi 100 mijë të punësuar në sektorin privat, të cilët kanë ngelur pa të ardhura si rezultat i vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ka qenë qëllimi që të ndihmon dhjetëra-mijëra biznese. Qëllimi që të ndihmohen qindra-mijëra të cilët përfitojnë nga përkrahje nëpërmjet pagesave që bëhen nga Buxheti i Kosovës.

Të përkrahen komunat e Kosovës në një situatë të jashtëzakonshme që është lufta kundër pandemisë. Të përkrahen komunitet jo shumicë dhe të gjitha kategoritë të cilat janë të specifikuar në ligj. Ligji nuk është ligj i cili ka të bëjë me Ligjin e Buxhetit, po është ligj i veçantë dhe nëpërmjet ligjit të veçantë ne kemi ardhur me propozim që ta krijojmë bazën legale, me qëllim që institucionet të kenë mundësi që të veprojnë.

E di që Qeveria mundet deri në 30 ditë, por kur ekziston vullneti dhe nuk ka situatë më e rëndë se kjo për Kosovën, po edhe për globin, sepse këto deklarata mund t'i jep edhe brenda një dite. Prandaj, në aspektin procedural dhe teknik, gjithçka ka mundur që të procedohet tutje. Mirëpo, duke e parë situatën që nuk ka vullnet dhe kur nuk ka vullnet, atëherë ka edhe përgjegjësi dhe ka përgjegjësi për këtë punë.

Ne si grup parlamentar i PDK-së, duke e ditur që me rezolutë, se qëllimi i rezolutës ka qenë të vijmë deri të ligjet, të vijmë deri te krijimi i bazës legale. Ne bazuar edhe në nenin 56, paragrafi 5, sipas të cilit propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend, deri para fillimit të votimit, dhe meqë të njëjtat rregullave vlejnë edhe për mocionin përmbajtësor, ne e

tërheqim meqë nuk ka pajtueshmëri që këto projektligje të propozuara të futen në rend të ditës dhe të trajtohen dhe të aprovohen nga ky Kuvend. Faleminderit!

KRYETARJA: Mua më duhet ta sqaroj edhe njëherë. Komentari i Kushtetutës thotë që nuk kam të drejtë që të vendos pika të reja të rendit të ditës në seancë të jashtëzakonshme.

Kështu që nuk ka ndonjë qëllim tjetër, përtej atij procedural në rastin konkret.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë,

Meqenëse edhe propozuesit e sqaruan që tërhiqen edhe nga diskutimi për rezolutën, po e përsërisë që unë e kam për obligim që ta respektojë Rregulloren dhe Kushtetutën, lidhur me çështjen e seancave të jashtëzakonshme.

Natyrisht që në çështje të vullnetit politik, unë nuk mund të përziej, sepse vullneti politik mund të çojë edhe te ndryshimi i Rregullores edhe tek ndryshimet e rregullave të tjera. Përderisa ekziston kjo Rregullore e Kuvendit dhe kjo Kushtetutë që është në fuqi, unë i respektoj këto.

Meqenëse edhe propozuesi e ka tërhequr propozimin, e ndërpresë këtë seancë, sepse pas tërheqjes së propozuesit nuk ka sesi ta hapim debatin më tej. Faleminderit!

Mbyllet seanca e kërkuar nga 48 deputetët nënshkrues.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*